



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.53**

**9 maj**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.5294 datë 8.5.2007	Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme në zonën zgjedhore nr.86 .....	1407
Vendim i KM nr.246, datë 11.4.2007	Për një shtesë fondi, për zbatimin e sistemit të automatizuar në doganë “ASYCUDA WORLD” .....	1407
Vendim i KM nr.248, datë 27.4.2007	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.....	1408
Vendim i KM nr.249, datë 27.4.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme, për financimin e veprimtarisë “VERNISSAGE” që do të zhvillohet në Venecia, Itali .....	1409
Vendim i KM nr.251, datë 27.4.2007	Për disa ndryshime në vendimin nr.786, datë 17.12.1998 të Këshillit të Ministrave “Për kualifikimin shkencor, pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve, pedagogjikë e kërkimorë”, të ndryshuar .....	1409
Vendim i KM nr.255, datë 27.4.2007	Për fondin e ekselencës, për mbështetje financiare të studentëve e shkencëtarëve të rinj, të shkëlqyer .....	1411
Vendim i KM nr.257, datë 11.4.2007	Për kriteret dhe procedurën e kompensimit fizik me troje shtetërore, të subjekteve të shpronësuara, në disa raste të veçanta	1412
Vendim i ERE nr.28, datë 4.5.2007	Për miratimin e kohëzgjatjes së periudhës transitore për aplikimin e faturimit aforfe për klientët familjarë pa matës të energjisë elektrike.....	1414
Vendim i ERE nr.29, datë 4.5.2007	Për vendosjen e gjobës KESH sh.a.....	1415

**DEKRET**  
**Nr.5294, datë 8.5.2007**

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME NË ZONËN ZGJEDHORE**  
**NR.86**

Në bazë të nenit 92 germa “gj” të Kushtetutës dhe të nenit 14 pika 3 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

**DEKRETOJ:**

Zgjedhjet e pjesshme për deputet në zonën zgjedhore nr.86 të zhvillohen ditën e dielë, datë 17 qershor 2007.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Alfred Moisiu**

**VENDIM**  
**Nr.246, datë 11.4.2007**

**PËR NJË SHITESË FONDI, PËR ZBATIMIN E SISTEMIT TË AUTOMATIZUAR NË**  
**DOGANË “ASYCUDAWORLD”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Investime” t’i shtohet fondi 110 (njëqind e dhjetë) milionë lekë, për modernizimin dhe migrimin e sistemit të automatizuar të procedurave doganore ASYCUDA ++ në ASYCUDAWORLD, të zhvilluar nga konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregti dhe zhvillim (UNCTAD).
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.248, datë 27.4.2007**

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË  
INFORMACIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si institucion juridik publik, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë.
2. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) ka objekt të veprimtarisë:
  - a) Hartimin dhe zbatimin e politikave, të strategjive, akteve, ligjore dhe nënligjore, për zhvillimin e sektorit të shoqërisë së informacionit (SHI);
  - c) Bashkërendimin e politikave dhe të programeve në fushën e SHI-së;
  - ç) Nxitjen e investimeve në fushën e SHI-së;
  - d) Promovimin e teknologjive të reja në fushën e SHI-së;
  - dh) Edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-së nga publiku.
3. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka këto detyra dhe përgjegjësi specifike:
  - a) Harton strategjinë kombëtare për zhvillimin e shoqërisë së informacionit dhe bashkërendon punën për zbatimin e saj;
  - b) Përgatit bazën ligjore për zhvillimin e SHI-së;
  - c) Bashkërendon reformat, programet dhe projektet në fushën e SHI-së, që zbatohen në të gjitha institucionet publike;
  - ç) Përcakton standardet e TIK-së për administratën publike;
  - d) Zhvillon një rrjet të brendshëm të TIK-së për administratën publike, përfshi krijimin e rrjetit qeveritar (*GovNet*) dhe të portalit qeveritar;
  - dh) Bashkërendon projektet për kompjuterizimin e të gjithë sektorëve të administratës publike, duke i dhënë përparësi kompjuterizimit të institucioneve, që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për publikun dhe bizneset;
  - e) Drejton strategjinë dhe projektet për ngritjen e shërbimeve *on line* të administratës publike, përfshi të gjitha shërbimet e qeverisjes elektronike;
  - ë) Mbështet dhe bashkërendon projektet për dixhitalizimin e bazës ligjore, të dokumentacionit, arkivave, bibliotekave, etj;
  - f) Nxit dhe mbështet përdorimin e internetit dhe TIK-së në shkolla, përfshi kompjuterizimin dhe aksesin në internet të të gjitha shkollave publike;
  - g) Nxit dhe mbështet zhvillimin e biznesit *on line* (ebusiness);
  - gj) Propozon politika, nxitëse dhe mbështetëse, për zhvillimin e infrastrukturës së TIK-së dhe të investimeve private në këtë fushë;
  - h) Promovon përhapjen e internetit dhe aksesin e publikut në shërbimet *on line*;
  - i) Promovon dhe mbështet rritjen e aftësive për përdorimin e kompjuterit dhe të internetit nga qytetarët;
  - k) Bashkëpunon në fushën e SHI-së me institucione të tjera shtetërore dhe ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat.
4. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit.
5. Agjencia financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga projekte të ndryshme, nga institucione të huaja, si dhe nga burime të tjera, të ligjshme.

6. Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të Kryeministrit.

7. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj Agjencie rregullohen me Kodin e Punës. Pranimi në punë bëhet sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

8. Efektet financiare, në shumën 33 282 368 (tridhjetë e tre milionë e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2007, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

9. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.249, datë 27.4.2007**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË  
E PUNËVE TË JASHTME, PËR FINANCIMIN E VEPRIMTARISË “VERNISSAGE” QË  
DO TË ZHVILLOHET NË VENECIA, ITALI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi prej 40 000 (dyzet mijë) eurosh (ekuivalenti në lekë sipas kursit të ditës), për financimin e veprimtarisë “VERNISSAGE” (Bialja e pikurës), që do të zhvillohet në Venecia, Itali.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.251, datë 27.4.2007**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.786, DATË 17.12.1998 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KUALIFIKIMIN SHKENCOR, PASUNIVERSITAR  
DHE PËR KLASIFIKIMIN E PUNONJËSVE, PEDAGOGJIKË E KËRKIMORË”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në vendimin nr.786, datë 17.12.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i fundit i pikës 4.2.1. ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ky titull mund t’u jepet, pa respektuar afatet e mësipërme kohore, kandidatëve, që kanë mbaruar studimet, universitare dhe pasuniversitare (doktoraturë), me rezultate të larta (notë mbi 9), kur ata plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të kenë botuar, si autorë të parë, së paku pesë artikuj shkencorë origjinalë në gjuhë të huaj. Tri prej tyre duhet të jenë botuar në revista shkencore, me bord editorial, dhe një artikull të jetë i botuar në një revistë, me faktor impakti;

- Të kenë bërë, si autorë të parë, së paku pesë referime ose prezantime në kongrese ose konferenca shkencore ndërkombëtare, të botuara në “proceedings” me numër ISSN-je;

- Të kenë botuar, në gjuhë të huaja, një monografi, të ndryshme nga disertacioni i doktoratës ose masterit, e cila zëvendëson tre artikuj shkencorë origjinalë dhe dy referime në kongrese/konferenca ndërkombëtare;

- Të kenë botuar në gjuhën shqipe dy monografi, të ndryshme nga disertacioni i doktoratës ose masterit, të cilat zëvendësojnë tre artikuj shkencorë origjinalë dhe dy referime në kongrese/konferenca ndërkombëtare;

- Të kenë dhënë mësim (leksione e seminare) në shkollën e lartë, së paku për pesë vite akademike;

- Të kenë bërë punë kërkimore, të kenë dhënë mësim në një shkollë të lartë a qendër kërkimore — mësimore, perëndimore, së paku për një vit akademik, dhe të kenë fituar në një universitet të huaj një status të ngjashëm me atë të profesorit të asociuar;

- Të jenë titullarë, së paku në një lëndë;

- Të kenë dhënë kontribut në zhvillimin akademik të shkollës së lartë;

- Të jenë në gjendje të japin mësim në një gjuhë të huaj, perëndimore.”.

b) Paragrafi i fundit i pikës 4.2.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ky titull mund t’u jepet, pa respektuar afatet e mësipërme kohore, kandidatëve, që kanë mbaruar studimet, universitare dhe pasuniversitare (doktoraturë), me rezultate të larta (notë mbi 9), kur ata plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të kenë botuar, si autorë të parë, së paku tre artikuj shkencorë origjinalë, në gjuhë të huaj, prej të cilëve, së paku, dy në revista shkencore ndërkombëtare, me bord editorial;

- Të kenë bërë, si autorë të parë, së paku tri referime ose prezantime, në kongrese ose konferenca shkencore, ndërkombëtare, të botuara në “proceedings” me numër ISSN-je;

- Të kenë zhvilluar veprimtari, kërkimore ose mësimore, në një universitet a qendër kërkimore, të njohur, ndërkombëtare, për së paku një vit akademik;

- Të kenë dhënë mësim (leksione e seminare), së paku për dy vite akademike, pas përfundimit të doktoratës;

- Të jenë në gjendje të japin mësim në një gjuhë të huaj, perëndimore.”.

2. Pëzullimin e procesit të dhënies së gradave dhe të titujve për punonjësit e institucioneve kërkimore, në varësi të një dikasteri ose të Akademisë së Shkencave, deri në përfundimin e organizimit të këtyre institucioneve dhe në përcaktimin e rregullave të reja për to.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.255, datë 27.4.2007**

**PËR FONDIN E EKSELENCËS, PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË STUDENTËVE E SHKENCËTARËVE TË RINJ, TË SHKËLQYER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e një fondi të veçantë, të financuar nga Buxheti i Shtetit, në masën deri në 100 000 000 (njëqind milionë) lekë në vit, si edhe nga donacione, për mbështetje financiare të studentëve dhe shkencëtarëve shqiptarë, të shkëlqyer, i cili përdoret nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për:

a) bursa të posaçme, për studentë, që bëjnë studimet e doktoratës, jashtë shtetit;  
b) bursa të posaçme, për shkencëtarë të rinj, që bëjnë studimet e postdoktoratës, jashtë shtetit;

c) çmime për studentë, fitues në konkurse dhe olimpiada ndërkombëtare;

ç) mbështetje për botime shkencore, me nivel të lartë shkencor.

2. Të drejtën, për t’u mbështetur financiarisht, sipas pikës 1 të këtij vendimi, e kanë:

a) studentët që ndjekin, jashtë shtetit, studimet e doktoratës, pasi kanë përfunduar ciklin e parë dhe të dytë të studimeve universitare, me notë mesatare mbi 9.5, për studime të kryera brenda shtetit, ose, përkatësisht, mbi 8.5 për studime të kryera jashtë shtetit, në secilin cikël studimi, si dhe shkencëtarët e rinj, pasi kanë përfunduar studimet e doktoratës me vlerësim maksimal kur:

i) janë pranuar në një universitet të huaj, për studimet e doktoratës apo postdoktoratës;

ii) kanë përgatitur një projekt për kërkim gjatë studimeve të doktoratës apo postdoktoratës jashtë shtetit;

iii) pranojnë të punojnë, së paku 5 vjet në Shqipëri, pas përfundimit të studimeve të doktoratës apo postdoktoratës jashtë shtetit;

iv) nuk janë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar dhe nuk kanë të ardhura personale mbi 100 000 lekë në muaj.

b) fituesit në konkurse dhe olimpiada ndërkombëtare, me reputacion, në formë çmimesh;

i) nxënës dhe studentë, të klasifikuar në tri vendet e para;

ii) studentë dhe doktorantë, që kanë përfunduar studimet, universitare ose pasuniversitare, me rezultatin “shkëlqyer”, në një universitet të huaj, që renditet në 30 më të mirët e botës.

c) autorët e botimeve me nivel të lartë shkencor, si të:

i) artikujve shkencorë origjinalë dhe analizave shkencore (review), pranuar në revistat shkencore të huaja, që janë të indeksuara;

ii) monografive, të shkruara në gjuhë të huaj dhe që kërkohen edhe nga institucione jashtë shtetit;

ii) veprave fundamentale, që vlerësohen të një rëndësie të veçantë për shkencën dhe kulturën mbarëshqiptare.

3. Ministri i Arsimit dhe Shkencës shpjegon, me udhëzim, me hollësi, rregullat për zbatimin e kriterëve, për çdonjërin nga bursat e parashikuara, që aplikohen për studentët dhe shkencëtarët e rinj. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, para fillimit të procedurave për aplikime për bursë, boton udhëzimin në Fletoren Zyrtare.

4. Kriteret për përzgjedhjen e shkollave të larta jashtë shtetit, në raport me koston e kualifikimit, fushat parësore, numrin e bursave për secilën kategori, në varësi edhe të fondit të vënë në dispozicion për këtë qëllim, përcaktohen nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës, i cili miraton edhe masën e bursës së posaçme, që jepet, në një vit akademik, në shkollat e larta jashtë shtetit.

5. Përzgjedhja e kandidatëve kryhet para fillimit të çdo viti akademik, nga komisione përzgjedhëse, të ngritura me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Këto komisione kanë në përbërje profesorë të universiteteve, në varësi të fushës, si dhe një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kur fondi i veçantë plotësohet edhe nga donacione, në komision merr pjesë edhe një përfaqësues i donatorëve.

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Udhëzimi botohet edhe në Fletoren Zyrtare.

6. Lista përfundimtare e kandidatëve të përzgjedhur dhe masa e bursës për secilin prej tyre miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, pasi kandidati të ketë nënshkruar deklaratën, e miratuar nga Ministri, për punësim në Shqipëri. Lista botohet në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

7. Studentët, të cilët ndërpresin studimet për më shumë se një vit (akademik), përveç rasteve kur paraqesin raport mjekësor, humbin të drejtën e përfitimit të mëtejshëm të bursës së studimit. Studentët, të cilët nuk i japin të gjitha provimet apo e përfundojnë vitin me notë mesatare më të ulët se nota 9 (të ekuivalentuar, sipas vlerësimit të shtetit përkatës, ku studiojnë) apo marrin ndonjë notë më të ulët se nota 8, nuk përfitojnë bursë në vitin pasardhës.

8. Studentët dhe shkencëtarët e rinj, që kanë përfituar bursë sipas këtij vendimi, kur, pas përfundimit të studimeve refuzojnë të punojnë në Shqipëri, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e lidhur, detyrohen të kthejnë shumën e marrë në formë burse.

9. Masa e fondit të veçantë "Për mbështetje financiare për shkencëtarë të rinj shqiptarë, të shkëlqyer", për vitin 2007, është 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, e cila është planifikuar në buxhetin e miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.257, datë 11.4.2007**

**PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E KOMPENSIMIT FIZIK ME TROJE**  
**SHTETËRORE, TË SUBJEKTEVE TË SHPRONËSUARA, NË DISA RASTE TË VEÇANTA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 29 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në fondin e pasurive të paluajtshme, që do të përdoren për kompensim fizik të menjëhershëm, bëjnë pjesë sipërfaqe toke, pronë shtetërore, të cilat ndodhen brenda vijave kufizuese të qyteteve, që, për shkak të pozicionit dhe të sipërfaqes së vogël, nuk mund të shërbejnë për kompensimin e subjekteve të shpronësuar, në përgjithësi.

2. AKKP-ja të përdorë, për kompensim fizik të menjëhershëm, troje, të cilat në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme figurojnë në pronësi të shtetit dhe plotësojnë të paktën njërën nga kushtet e mëposhtme:

a) Trualli të ndodhet ndërmjet ose ngjitur pronave, të kthyer subjekteve të shpronësuar dhe kjo sipërfaqe të jetë jo më e madhe se 10 për qind e sipërfaqes së kthyer këtyre subjekteve.

b) Trualli të ndodhet ndërmjet dy ose më shumë pronave, ku ka shërbyer si rrugicë apo servitut, i cili, sipas vërtetimit të organit përkatës, e ka humbur funksionin, për të cilin ka ekzistuar.

c) Trualli të ndodhet në bashkim të dy ose më shumë pronave me sipërfaqe jo më të madhe

se 10 për qind e sipërfaqes së tyre dhe të përfshihet në një ndërtim, publik ose privat, i cili, sipas vërtetimit të organeve përkatëse, nuk prek infrastrukturën apo urbanistikën në qytet.

3. Subjektet e shpronësuara, që të përfitojnë kompensim fizik të menjëhershëm, sipas këtij vendimi, duhet të paraqesin:

a) Kërkesën për kompensim fizik të menjëhershëm, pranë zyrës rajonale të AKKP-së, në qark.

b) Vendimin e AKKP-së ose të ish-Komisionit të Kthimit të Pronave, që u njeh të drejtën e kompensimit me truall.

c) Vërtetimin nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, se trualli është pronë shtetërore dhe plotëson kushtet e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

ç) Vërtetimin nga bashkia, se sipërfaqja e truallit, sipas studimit dhe/ose gjendjes faktike, e ka humbur rëndësinë dhe funksionin.

d) Vërtetimin nga organi përkatës, se ndërtimi, publik apo privat, në të cilin do të përfshihet trualli, sipas shkronjës “c” të pikës 2 të këtij vendimi, nuk prek infrastrukturën apo urbanistikën në qytet.

4. Zyra rajonale e AKKP-së në qark, brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës, pasi verifikon zbatimin e pikave 2 e 3 të këtij vendimi, i përcjell AKKP-së kërkesën e subjektit të shpronësuar, për kompensim fizik të menjëhershëm, si dhe dokumentacionin, e përmendur në pikën 3 të këtij vendimi.

5. AKKP-ja, pasi shqyrton kërkesën dhe vëren se kushtet, e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi plotësohen dhe se dokumentet, e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, janë të vlefshme e të rregullta, ndjek, për realizimin e kësaj procedure, hapat e mëposhtëm:

a) Bën botimin në Fletoren Zyrtare të të dhënave të truallit, sipas kategorisë dhe vlerës së përcaktuar, duke lënë si afat të paraqitjes së kërkesave të mundshme deri në 30 ditë nga data e botimit.

b) Pranon të gjitha kërkesat e paraqitura për këtë truall dhe i shqyrton ato brenda afateve të parashikuara në nenin 17 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

c) Merr vendim për kompensim fizik të menjëhershëm, sipas këtij vendimi, duke respektuar radhën e preferencës, si më poshtë vijon:

i) Trualli i jepet, për kompensim fizik të menjëhershëm, subjektit të shpronësuar, të cilit i është njohur ky truall, por nuk i është kthyer, sepse, në kohën e daljes së vendimit përkatës, trualli vlerësohej i zënë.

ii) Trualli i jepet subjektit të shpronësuar, nëse plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjën “a” dhe/ose “b” të pikës 2 të këtij vendimi.

iii) Trualli u jepet subjekteve të tjera, të shpronësuara, nëse nuk ka aplikantë, sipas përparësive të përmendura më lart, dhe nëse plotësohet kushti, i përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 2 të këtij vendimi.

6. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dërgon për regjistrim në zyrën rajonale përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme vendimin për kompensim fizik të menjëhershëm.

7. Ngarkohet Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.28, datë 4.5.2007**

**PËR MIRATIMIN E KOHËZGJATJES SË PERIUdhËS TRANSITORE PËR APLIKIMIN E FATURIMIT AFORFE PËR KLIENTËT FAMILJARË PA MATËS TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, 26, pika 1, dhe 52, pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 4.5.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga KESH sh.a. për përcaktimin e kohëzgjatjes së periudhës transitore për aplikimin e faturimit aforfe për klientët familjarë pa matës të energjisë elektrike,

**VENDOSI:**

- Kohëzgjatja e aplikimit të faturimit aforfe për klientët familjarë pa matës të energjisë elektrike do të jetë deri më 31 dhjetor 2007.
  - Sasia e energjisë elektrike e faturimit aforfe për klientët familjarë pa matës të energjisë elektrike (ndarë sipas rretheve) deri më 31 dhjetor 2007, do të jetë sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
  - Ngarkohet KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

Sasia e energjisë elektrike e faturimit

Nr.	Emërtimi	Niveli i aforfesë verë (në kWh/muaj)	
		Qytet	Fshat
1	Tiranë qytet	400	
2	Tiranë fshat		290
3	Durrës	400	290
4	Kavajë	400	230
5	Krujë	390	290
6	Shijak	0	290
7	Fier	390	340
8	Patos	390	220
9	Ballsh	390	220
10	Vlorë	350	220
11	Bilisht	0	0
12	Kolonjë	0	0
13	Korçë	340	220
14	Pogradec	0	0
15	Gramsh	0	0
16	Librazhd	0	0
17	Peqin	0	0

Nr.	Emërtimi	Niveli i aforfesë dimër (në kWh/muaj)	
		Qytet	Fshat
1	Tiranë qytet	600	
2	Tiranë fshat		400
3	Durrës	500	400
4	Kavajë	550	400
5	Krujë	450	350
6	Shijak	0	400
7	Fier	500	350
8	Patos	450	300
9	Ballsh	450	300
10	Vlorë	500	300
11	Bilisht	0	0
12	Kolonjë	0	0
13	Korçë	500	300
14	Pogradec	0	0
15	Gramsh	0	0
16	Librazhd	0	0
17	Peqin	0	0

18	Elbasan	0	0
19	Berat	390	220
20	Kuçovë	0	220
21	Lushnjë	390	290
22	Skrapar	0	0
23	Has	290	220
24	Kukës	400	220
25	Lezhë	390	280
26	Koplik	390	280
27	Pukë	0	0
28	Tropojë	400	220
29	Shkodër	400	250
30	Bulqizë	0	220
31	Dibër	0	220
32	Laç	290	250
33	Mat	0	220
34	Mirditë	0	0
35	Gjirokastrë	0	220
36	Përmet	0	0
37	Sarandë	0	0
38	Tepelenë	0	0
39	Delvinë	0	0

18	Elbasan	0	0
19	Berat	500	350
20	Kuçovë	0	300
21	Lushnjë	450	350
22	Skrapar	0	0
23	Has	450	300
24	Kukës	550	300
25	Lezhë	550	350
26	Koplik	400	300
27	Puke	0	0
28	Tropojë	450	300
29	Shkodër	500	300
30	Bulqizë	0	250
31	Dibër	0	250
32	Laç	450	300
33	Mat	0	300
34	Mirditë	0	0
35	Gjirokastrë	0	300
36	Përmet	0	0
37	Sarandë	0	0
38	Tepelenë	0	0
39	Delvinë	0	0

**VENDIM**  
**Nr.29, datë 4.5.2007**

**PËR VENDOSJEN E GJOBËS KESH SHA**

Në mbështetje të neneve 9, 64, pika 1 germa “c” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e datës 4.5.2007, mbasi konstatoi moszbatimin e vendimit nr.62, datë 3.10.2006 “Për përcaktimin e kohëzgjatjes së periudhës transitorë dhe të sasisë së faturimit aforfe për klientët familjarë që nuk janë të pajisur me matës të energjisë elektrike”

**VENDOSI:**

1. Vendosjen e gjobës për KESH sh.a. në masën 300 000 lekë.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468  
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:
  1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)..... 1500
  2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) ..... 600
  3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300
  4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500

### Botime të reja

- 1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000
- 2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500
- 3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000
- 4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500
- 5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000
- 6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800
- 7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500
- 8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000
- 9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500

Hyri në shtyp më 9.5.2007  
Doli nga shtypi më 9.5.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “Grafon”  
Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë